



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet Njoftimi i Shkurtuar i Konkursit të projektimit në formë shkresore për procedurën e prokurimit Konkurs Projektimi me objekt **“Konkurs për ideimin, krijimin dhe zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset në sheshin Europa Piazza, Fier”**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

BASHKIA FIER

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Fier
Adresa Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15
Tel/Faks +355 34 410 650
E-mail prokurimetfier@gmail.com
Ueb-faqe www.app.gov.al; www.bashkiafier.gov.al;

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Konkurs Projektimi me 2 faza në formë shkresore

Bazuar në V.K.M. nr.384 datë 30.06.2021 “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik” i ndryshuar, me VKM nr.22 datë 18.01.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.384 datë 30.06.2021 “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”, për procedurën konkurs projektimi fazat nga dorezimi i kërkesave për shprehje interesi e në vijim zhvillohen në formë shkresore.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-60965-03-01-2023

4. Objekti i kontratës: “Konkurs për ideimin, krijimin dhe zbatimin e Veprës së Artit që do të vendoset në sheshin Europa Piazza, Fier”

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit është se autoriteti kontraktor Bashkia Fier, bazuar në shkronjën ‘b’, të pikës 2, të nenit 57 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e

rrëgullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe në shkronjën ‘b’, të pikës 1, të nenit 104 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: “b) konkurset e projektimit, të organizuara si pjesë e një procedure, e cila çon në dhënien e një kontrate publike për shërbime.”, ka për qëllim që nëpërmjet kësaj procedure Konkurs Projektimi në formë shkresore me 2 faza, të përfitojë idenë apo krijimin artistikë për veprën artistike më të vlerësuar nga juria, si dhe shërbimin e zbatimit në terren të kësaj vepre artistike në përputhje me krijimin artistikë të shpallur fitues, nga kandidati i suksesshëm që do të përzgjidhet fitues në përfundim të konkursit të projektimit, përfshirë zbatimin e saj me të gjithë elementetë artistikë dhe teknikë, deri në vendosjen e saj në hapësirën publike të miratuar për këtë qëllim, në përputhje me projektin inxhinierik apo arkitektonik për realizimin dhe ndërtimin e veprës, të propozuar nga kandidati që do të përzgjidhet fitues, në këtë procedurë prokurimi Konkurs Projektimi.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 105 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier synon që në vijim të këtij Konkursi, bazuar në pikën 3 të nenit 47 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, do të kryej procedurat ligjore të negociimit dhe në rastin e përfundimit të tyre me sukses, do të lidhë një kontratë shërbimi për zbatimin në terren të kësaj vepre artistike në përputhje me krijimin artistikë të shpallur fitues, me kandidatin e suksesshëm që do të përzgjidhet fitues në përfundim të konkursit, përfshirë zbatimin e saj me të gjithë elementetë artistikë dhe teknikë, dhe ky informacion përfshihet në njoftimin publik të konkursit dhe në DST.

Realizimi i punimeve të ndërtimit dhe instalimi i veprës, duhet të realizohet nga një shoqëri e licencuar, e cila është përgjegjëse për ndërtimin dhe sigurinë, si gjatë instalimit ashtu edhe pas saj.

5. Vlera e konkursit : _____

6. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime të ofruara nga artistë - 92312240-5

7. Kohëzgjatja e kontratës për zbatimin në terren të veprës artistike ose afati për zbatimin e saj: jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë .

8. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje (faza 1): 23/ 03/ 2023 (d/m/v), Ora: 10:00.

Vendi: Bashkia Fier, Fier, Shqiperi.

Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar për fazën e I, në adresën: zyra e protokoll/arkives, kati i II, godina e Bashkise Fier, Fier, Shqiperi.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTARI I AUTORIZUAR**

Zv.Kryetari

Andius OLLDASHI